

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRË

02 Nr. / Br 1107/21

Nr. i fq. / Br. sh - 04 -

Data: / Datum 22.09.2021

VUSHTRRI - VUÇITRË



KOMUNA VUSHTRRIË



01-2120 Dt. 22.09.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA



N.H. "Ibër-Lepenc" sh.a. - Prishtinë

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOMUNËS SË VUSHTRRIË

DHE

"IBËR - LEPENC" Sh.A

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT PËR UJITJEN E KULTURAVE BUJQËSORE NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

1. "IBËR LEPENC" Sh.A- Prishtinë, përfaqësuar nga z. Januz Kabashi
2. KOMUNË VUSHTRRI, përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna)

[Handwritten signature]
J.K

QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i obligimeve të përbashkëta institucionale duke përfshirë mbështetjen financiare nga Komuna e Vushtrrisë në funksion të ujitjes së 700 ha të kulturave bujqësore në komunën e Vushtrrisë.

Realizimi i Projektit për ujitje në Komunën e Vushtrrisë, duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të Komunës, është në përputhje me politikat e Komunës së Vushtrrisë, si dhe ka për qëllim përkrahjen e bujqve në Komunën e Vushtrrisë, duke ndikuar në këtë formë në rritjen e rendimenteve bujqësore.

II

OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

1. Palët, në funksion të realizimi të qëllimit të përcaktuar në nenin një (1) të këtij Memorandumi marrin përsipër këto obligime të përbashkëta:
 - 1.1. Mbështetje financiare në shumën prej 77,000.00 euro nga Komuna e Vushtrrisë, të cilat mjete do të paguhen nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kategoria e subvencioneve, në llogarinë e N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A. Prishtinë, (140100000922261 Banka Ekonomike), jo më vonë se 30.09.2022.
 - 1.2. Kujdesi që mos të tejkalohet shifra prej 700 ha nga N.H "Iber-Lepenc".
 - 1.3. Sigurojnë realizimin e suksesshëm të projektit dhe përmbushjen e qëllimit të këtij memorandumi;
 - 1.4. Udhëheqin në bashkëpunim procesin e mbështetjes financiare në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

III

OBLIGIMET E PALËVE

1. Komuna e Vushtrrisë

- 1.1. Mbështetë realizimin e projektit përmes ndarjes së buxhetit në shumë prej 77,000.00 euro të përcaktuar në nenin dy (2), (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) të këtij Memorandumi.
- 1.2. Komuna e Vushtrrisë merr përsipër pagesën për ujitje sipas kërkesave të fermerëve deri në 700 ha, në rast se numri i kërkesave është me i vogël, atëherë edhe pagesa do të jetë në proporcion me numrin e kërkesave, por asesi mos të tejkalohen shifra prej 700 ha.
- 1.3. Me rastin e ekzekutimit të mjeteve financiare nga Komuna e Vushtrrisë, N.H. "Iber-Lepenc" Sh.A, merr përsipër të përcjellë tek komuna, të dhënat për realizimin e projektit siç janë: kontratat për ujitje dhe proceset e evidentimit të ujitjes.



2. N.H. "Iber Lepenc" Sh.A

- 2.1. Në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë, kujdesen për realizimin e suksesshëm të projektit përmes ofrimit të çfarëdo asistence profesionale, administrative dhe teknike që mund të jetë e nevojshme dhe që është në përgjegjësinë dhe mandatin e saj.
- 2.2. N.H. "Iber - Lepenc" Sh.A. kujdeset që mos të tejkalohet shifra prej 700 ha, në rast të tejkalimit të buxhetit të përcaktuar nenin dy (2), (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) të këtij Memorandumi, N.H. "Iber - Lepenc" Sh.A. merr përsipër të sigurojë buxhetin shtesë, ose të liroj nga pagesa bujqët, të cilet i kanë kontratat për ujtime dhe proceset e ujitjes, e tërë kjo për trajtimin e barabartë të bujqëve.

IV ZBATIMI

Komuna e Vushtrrisë dhe N.H. "Iber Lepenc" Sh.A, përcjellin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë për veprime që duhet të ndërmerren në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë Memorandum.

V PLOTËSIM NDRYSHIMI APO SHKËPUTJA EVENTUALE E MEMORANDUMIT

1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve, por që nga ky memorandum nuk mund të lirohen palët, pa i përmbushur obligimet.
2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të fuqisë mbinatyrore -palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me njëra - tjetrën për veprimet që duhet të ndërmerren.
3. Afati i realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi duhet të arrihet gjatë sezonit të ujitjes në vitin 2022, jo më largë se data 30.09.2022
4. Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një aneks marrëveshje me shkrim midis palëve.
5. Ky Memorandum ka titull ekzekutiv.

VI ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.




VII
NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në katër (4) kopje identike origjinale, nga dy (2) për palët nënshkruese.

VIII
HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.


Xhafer FAHRI
Kryetar i Komunës së Vushtrisë



Januz Kabashi
Kryeshef i N.H. "Iber Lepenc" Sh.A



Nënshkruar më 22/09/2021